

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: J u erdhi fundi!
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/dita-e-106-te-e-protestes-qytetaret-zbresin-serish-ne-shesh-kerkohe-i513947
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:02:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 17:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ed9fea706852b0fe1b8e2f70faacef91cd1fa7fc2889bd2a9a8daed37799931
TEKSTI	f829a55e1ddc34917173f4e5d3cf55406bb5b2aec2f5748c6a05c698ddfbff79
PAMJA	d89cf1e6256c336d5933bcf5ebb70d0262e1e80cc05293dc724325c7a05f3448

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	353ef0dfebd8e66047140d502bfb106c5ffa7364fb0ff4c46b316bd118b872ba
E MËPARSHMJA	8501662fd9ff3bbe3be70188781ec978d2afb016cf9067cea854417f26c3844
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/353ef0dfebd8e66047140d502bfb106c5ffa7364fb0ff4c46b316bd118b872ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

4 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

5 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

10 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e dëgjur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

10 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhëmbët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

LIVE UPDATES

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

• Qytetarët u mblodhën sot në ditën e 106-të të revoltës së tyre. • Ata u organizuan fillimisht në sheshin "Skënderbej" dhe më pas vijuan marshimin drejt Kryeministrisë, ku dhe zhvilluan fjalimet e tyre. • Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ku artikuluan kërkesat e tyre dhe bënë thirrje për ndryshim. • Një qytetar ka deklaruar se kryeministri Rama u soll si sulltan në ditën e Çlirimit të Beratit, pasi u tha qytetarëve qepeni gojën, ndërsa kritikoi mënyrën e sjelljes së tij me banorët e Poliçanit. • Qytetari vijoi kritikën edhe ndaj qeverisjes, duke thënë se problemet nuk zgjidhen vetëm përmes ndryshimit të ministrave. • Aktivisti Mirjan Aliaj ishte një nga folësit në protestën e ditës së sotme, ku gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrisë u shpreh se kryeministri Rama i kanë dalë kundër edhe deputetët e tij. • Ai tha se populli duhet ta rrëzojë kryeministrin Rama nga qeveria, pasi në të kundërtën sipas tij Rama do të shesë vendin tek të huajt. • Aktivisti Arben Kola ka deklaruar se nga dita e nesërme mbledhja e qytetarëve në sheshin "Skënderbej" nis në orën 18:30. • Gjatë fjalës së tij para qytetarëve, Kola i bëri thirrje mërgatës ti bashkohet tubimit, duke theksuar se vendi rrezikon të shpopullohet. • Një qytetar tha se ndryshimi po vjen, duke theksuar se tashmë protestuesit kanë edhe mbështetjen e diasporës. • Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ai tha se kjo është java e mosbindjes civile, duke shtuar se pushteti nuk mund të jetë mbi popullin. • Protesta e cila nisi si një reagim i drejtpërdrejtë ndaj situatës së ndodhur në Zvërnec, përfundoi në kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. • Me pankarta në duar dhe flamuj kuqezi, protestuesit kanë bërë thirrje për ndryshim. Protesta ka bërë bashkë fëmijë, të moshuar, studentë, profesionistë, aktivistë dhe turistë. • Qytetarët kanë kërkuar plotësimin e pesë kërkesave të cilat përfshijnë dorëheqjen e panegociushme të kryeministrit Rama, krijimin e një qeverie teknike dhe ndryshime kushtetuese. • Tubimet janë shoqëruar me marshime nëpër rrugët kryesore të Tiranës, ndërsa qytetarët kanë ndaluar edhe pranë institucioneve të tjera, përfshirë Parlamentin, ku kanë përcjellë mesazhe ndaj deputetëve. • "Edi Rama, o tradhtar, me Shqipërinë mos bëj Pazar", "Rama, jep dorëheqjen", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Shqipëria kërkon revolucion", "O Erion, o legen, prite Ramën se po vjen" dhe "Ju erdhi fundi", këto ishin disa nga thirrjet e tyre.

12 artikuj për këtë temë.

1 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrisë, qytetarët nisin marshimin



editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje



Pamje

TIRANA- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet para Kryeministrit. Nën thirrjet "Nesër më shumë" dhe "Ju erdhi fundi", ata kanë finalizuar ditën e 106-të të revoltës së tyre.

Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrit ku bënë thirrje për ndryshim dhe kërkuan dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. "Shqipëri e Re" "Edi Rama, jep dorëheqjen", "Ju erdhi fundi", "Rama në burg, Berisha në burg" dhe "Ndryshim sistemi" ishin disa prej sloganeve të përsëritura gjatë protestës./Dosja.al

1 ORE ME PARE

"Ndryshimi po vjen, diaspora ka ardhur"/ Qytetari: Kjo është java e mosbindjes civile, pushteti nuk mund të jetë mbi popullin



Qytetari

TIRANA- Një qytetar tha se ndryshimi po vjen, duke theksuar se tashmë protestuesit kanë edhe mbështetjen e diasporës. Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para Kryeministrit, ai tha se kjo është java e mosbindjes civile, duke shtuar se pushteti nuk mund të jetë mbi popullin.

Sipas tij, kjo nuk është vetëm protestë, por thirrje për drejtësi. Në fund, ai u bëri thirrje policëve të bashkohen me qytetarët.

Qytetari: Diaspora ka ardhur, Shqipëria është zgjuar, bulevardi është mbushur plot shqiptarë. Këtë protestë nuk e ndalin dot me forcën e policisë apo me frikë e presion. Kjo është java e mosbindjes civile, të tregojmë që pushteti s'mund të jetë mbi popullin. Policë, ju bëj thirrje, dëgjoni zërin tonë dhe mos u bëni mbrojtje e politikës. Kjo nuk është vetëm protestë, por thirrje për drejtësi. Ndryshimi po vjen. Rama, o legen, jep dorëheqje menjëherë./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Viti i ri shkollor/ Profesori Lush Susaj: Mësues, mësojuni nxënësve të mos heshtin

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 22:43

Dita e 45-së e protestës/
Divjaka kundër shkrirjes me
Lushnjen: Do t'a fitojnë këtë
betejë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 20:34

FOTOLAJM/ Pankartat
pikante nga dita e 106-të e
protestës qytetare në Tiranë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja
për sigurinë në shkollat e
Shqipërisë

më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për
shkrirjen e bashkisë, Rama
përplasat me banorët e
Poliçanit dhe
kryebashkiakun socialist
Adriatik Zotkaj! Qytetarët
largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/
TikTokeri, me 4 milionë
ndjekës, që i tregoi botës një
Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në
drejtëm të një automjeti,
gjendet e djegur edhe një
makinë

Zgjedhjet në Suedi/ E
djathta ekstreme synon
pushtetin për herë të parë

insights

Ola Xama
Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Idriz Konjari



Lush Susaj

TIRANA- Profesori Lush Susaj ka dhënë një mesazh për prindërit dhe mësuesit në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para godinës qeveritare, ai këshilloj mësuesit që tju mësojnë fëmijëve të mos sheshin përballë padrejtësive.

Gjithashtu ai këshilloj prindërit që të shohin kushtet e shkollave, pasi vota e tyre ka rëndësi në të ardhmen. Në fund të fjalimit të tij, ai tha se klasat janë bosh si pasojë e shkopullimit, nuk ka cilësi dhe testimet ndërkombëtare janë propagandë.

Lush Susaj: Nuk kisha bërë plan të flisja, por e mora fjalën për t'i uruar vitin e ri mësuesit, e sidomos çdo fëmijë që fillojnë klasën e parë. Jo vetëm në Shqipëri, por nëpërmjet e mbesat tona e kanë filluar që më 1 shtator në vendet e Europës.

Ju bëj thirrje prindërve të Shqipërisë, shikoni se në çfarë gjendje i keni shkollat nesër nga vota juaj, çdo 4 vjet, për hasmin e kombit tuaj. Shikoni në çfarë gjendje e keni situatën e fëmijëve dhe situatën tuaj ekonomike, vetëm për gafën dhe dëmin që keni bërë çdo katër vjet. Mësoni të shihni interesat e fëmijëve dhe jo interesat e hajdutëve dhe qeverisë së korruptuar.

Me këtë rast, i bëj thirrje mësuesve të përpiqen me njerëzillëk dhe t'ua lehtësojnë vuajtjet ekonomike dhe situatën e fëmijëve, nxënëseve, t'ua mësojnë edukatën qytetare, patriotizmin, reagimin, punën dhe respektin për punën. T'ua mësojnë atdhetarinë dhe kurrë heshtjen. Është shumë i rëndësishëm.

Ne nuk kemi institucion më të lartë se shkollën shqipe, dhe këtë e kanë goditur në mënyrën më katastrofike. Ju lutem të gjithë prindërit e Shqipërisë, ta bojkotojnë propagandën nesër dhe t'ua kërkojnë ministrave e të gjithë qeveritarëve që punojnë për depolitizimin e sistemit arsimor.

Lërimi dokrrat dhe propagandën, uluni me këmbë në tokë dhe shikoni çfarë keni bërë. I keni klasat bosh, shikoni ku ka rënë cilësia, ku jemi në testimet ndërkombëtare dhe lërimi ato propaganda. Jemi larguar në PISA, jemi në vendin 96, kur në 2013 ishim në vendin e 50./Dosja.al

2 ORE ME PARE

“Mërgata të na bashkohet, ndryshe Atdheu do të ngelet pa shqiptarë”/ Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja në sheshin “Skënderbej” nis në orën 18:30



Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti


Powered by  tomorrow.



Arben Kola

TIRANA- Aktivisti Arben Kola ka deklaruar se nga dita e nesërme mbledhja e qytetarëve në sheshin “Skënderbej” nis në orën 18:30. Gjatë fjalës së tij para qytetarëve, Kola i bëri thirrje mërgatës ti bashkohet tubimit, duke theksuar se vendi rrezikon të shpopullohet.

Ai theksoi se në protestën e ditës së sotme ka shumë emigrantë, ndërsa i falenderoj edhe për pjesëmarrjen e tyre.



Arben Kola: Duke nisur nga nesër mbledhemi në shesh në orën 18:30 e më pas marshojmë drejt bulevardit të krimin. Një falënderim i veçantë i mërgatës që sa herë vjen zbukuron protestën dhe rrugët. Sot kemi më shumë shqiptarë jashtë se brenda atdheut. Ftoj mërgatën t'i bashkohen rrëzimit të qeverisë, ndryshe Atdheu ynë do të ngelet pa shqiptarë. Është shumë e rëndësishme të ktheheni, ndryshe do lini nipat e mbesat pa Atdhe. Sot është koha, do të jetë vonë nesër./Dosja.al

2 ORE ME PARE

FOTOLAJM/ Pankartat pikante nga dita e 106-të e protestës qytetare në Tiranë





Pankarta

TIRANA- Protesta qytetare në Tiranë ka shënuar ditën e sotme, ditën e 106-të të revoltës kundër klasës politike. Qytetaret janë ngritur në protestë nën thirrjet "Rama në burg! Berisha në burg!", "Opozitë e shitur".

Qytetarët kanë përcjellë mesazhet e tyre edhe përmes pankartave të vendosura në shesh, ku spikasin kritikant ndaj qeverisë dhe thirrjet drejtuesit. Në një pankartë, protestuesit thonë se Shqipëria nuk është pronë private dhe se taksat janë përgjegjësi e qeverisë.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.